

Titulli i lëndës: PROJEKTIM 4 – NDËRTHESAT KOMERCIALE DHE TREGTARE

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Arkitekturës
Titulli i lëndës:	PROJEKTIM 4 – NDËRTHESAT KOMERCIALE DHE TREGTARE
Niveli:	baçelor
Statusi i lëndës:	obligative
Viti i studimeve:	Viti III / semestri IV
Numri i orëve në javë:	2+2
Kreditë ECTS:	6 ECTS
Koha / Vendi:	sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof.ass.dr. Arta Xhambazi
Të dhënat kontaktuese:	arta.xhambazi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Kursi trajton arkitekturën komerciale e cila veçohet me një fokus të veçantë në zhvillimin e objekteve dhe hapësirave që reflektojnë kërkesat e biznesit. Elaborohen projektet e ndërtesave komerciale të cilat akomodojnë kërkesat ditore të bizneseve duke e bërë hapësirën kompatible me funksionin. Kursi vë në pah studimin e sjelljes së konsumatorit si dhe ndërveprimin e pronarëve të bizneseve me klientin. Poashtu, veçohet rëndësia e të kuptuarit të psikologjisë së shitjes dhe marketingut të produktit, bashkë me trendet aktuale të konsumatorëve.
Qëllimet e lëndës:	Kursi ka për qëllim që studentët të përvetësojnë njohuri lidhur me procesin e projektimit përmes përvetësimit të njohurive për organizimin hapësinor dhe teknologjinë e ndërtimit të objekteve që përdoren për qëllime komerciale siç janë mjediset tregtare, zyrat, hapësirat e parkimit, rekreimit etj.. Kjo arrihet duke e vënë theksin në tipologjinë funksionale të ndërtesave tregtare, karakteristikat e tyre në raport me lokacionin, funksionin, përzgjedhjen e strukturave adekuate, theksimin e kompozicionit arkitektonik si dhe interaksionin me ambientin e ndërtuar.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Në fund të kursit studenti: <ul style="list-style-type: none"> – Identifikon problematikat dhe veçoritë e arkitekturës komerciale në raport me funksionet specifike si parkimi, tregtia, administrata, rekreacioni por edhe trendin e ndërtesave shumëfunksionale – hibride, – Diskuton komponentët arkitekturale në ndërtesat e tjera komerciale si parakusht për nisjen e veprimtarisë vetanake, – Demonstron njohuritë për problemin e organizimit hapësinor si dhe zgjidhjeve konstruktive të ndërtesave komerciale, – Interpreton dhe krahason veçoritë e nëntipologjive të mjedisve tregtare në raport me kërkesat e klientëve dhe bizneseve si dhe – Arsyeton zgjidhjen ideore arkitektonike. –

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtime	2	15	30
Punë praktike			
Konsultime me mësimdhënësin	0.3	5	1.5
Puna në terren	4	3	12
Testi, punimi seminarik			
Detyrë shtëpie	2	15	30
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin final	2	7	14
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	1	1
Projektet, prezantimet, etj.	0.5	3	1.5
Total			150
Metodat e mësimdhënies:	Ligjërimi ex-catedra lidhur me problemet funksionale-konstruktive, analiza të projekteve si dhe temave që ndërlidhen me ligjëratat në mënyrë interaktive me studentët. Gjatë semestrit parashihet edhe vizitë studimore dhe punë hulumtuese në objektet komerciale-tregtare. Studenti pasi përpilon programin projektues, realizon detyrën semestrale me punë me mbikqyrje gjatë ushtrimeve, si dhe punë individuale në shtëpi dhe terren.		
Metodat e vlerësimit:	Vijimi i rregullt i ligjëratave dhe ushtrimeve është i obligueshëm. Marrja e kredive bëhet me verifikimin e prezencës dhe aktivitetit në ligjëratat dhe ushtime, me projektin semestral të vlerësuar pozitivisht si dhe provimin me shkrim të vlerësuar pozitivisht. Vlerësimi përfundimtar përbëhet 70 % nga puna semestrale dhe 30% nga provimi me shkrim.		
Literatura primare:	Shopping Environments: Evolution, Planning and Design, Peter Coleman, 2006 Shopping malls, Yeal Xie, Design Media Publishing, 2011 New Shopping Malls, Carles Broto, Om Books, 2007 Parkhäuser – Garagen: Grundlagen, Planung, Betrieb, Anton Pech et al, Birkhauser Architecture, 2009 Dimensions of Parking(5th ed.), Urban Land Institute, 2010		
Literatura shtesë:	Baiche, B. Walliman, N., Neufert-Architects' Data (3rd ed.), Oxford, 2000 New Retail, Raul A. Barreneche, Phaidon 2005		
Hartimi i planit mësimor			
Java	Titulli i ligjëratës		
Java 1:	Hyrje në syllabusin e lëndës		
Java 2:	Natyra dhe zhvillimi i mjediseve tregtare Pasqyrë e shkurtë e zhvillimit historik të objekteve tregtare Çështjet e rëndësishme sociale, planifikimi dhe ekonomia		

	Evolutioni historik i vendeve për tregti
Java 3:	Qendrat tregtare bashkëkohore tipologjitë dhe trendet; Principet e projektimit; Cka e bën një qendër tregtare të sukseshme? Programi, lokacioni, korniza konceptuale Principet e projektimit Tipet e akomodimit
Java 4:	Njohja me objektet garazhuese në strukturën e qytetit Tipologjia e objekteve garazhues Kategorizimi
Java 5:	Garazhat me rampa, njohja, përparësitë dhe ndarja e tyre sipas rampave
Java 6:	Garazha me rampa të drejta të gjata Garazha me rampa të drejta të shkurta
Java 7:	Garazha me rampa spirale me etazha të rrafshta Garazha me etazha të pjerrëta
Java 8	Konstruksioni, paisjet dhe përmbajtjet përcjellëse
Java 9:	Këmbësori dhe siguria në objektet garazhuese
Java 10:	Diskutim dhe analizë e projekteve bashkëkohore
Java 11:	Tregjet: e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja; Projektimi i tregut publik dhe strategjitë e projektimit
Java 12:	Diskutim dhe analizë e projekteve bashkëkohore të jediseve tregtare
Java 13:	Diskutim dhe analize e projekteve
Java 14:	Diskutim dhe analizë e projekteve bashkëkohore
Java 15:	Rikapitulim i kursit

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Të drejtën e vijimit të kursit **Projektim 4 – ndërtesat komerciale dhe tregtare** e kanë vetëm studentët që kanë të regjistruar vitin e tretë dhe të cilët kanë absolvuar lëndën Projektimit 2 – Objektet shumëbanesore.

Vijimi i rregullt i ligjëratave dhe ushtrimeve është i obligueshëm. Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.

Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimet.

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.

Marrja e kredive bëhet me verifikimin e prezencës dhe aktivitetit në ligjërata dhe ushtrime, me projektin semestral të vlerësuar pozitivisht si dhe vlerësimin me shkrim të vlerësuar pozitivisht.

Shënim | Të drejtë të hyrjes në provim në lëndën **PROJEKTIM 4 – NDËRTESAT KOMERCIALE DHE TREGTARE**, kanë vetëm studentët të cilëve elaborati semestral u vlerësohet me notë pozitive si dhe të cilët nuk kanë më shumë se tre mungesa të arsyeshme/të paarsyeshme në ligjërata ose ushtrime.